

SHPALLJE E VENDI TË LIRË TË PUNËS**Forca Ajrore****Tabela .1**

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Inter vista	Fillimi	Mbarimi
1	Punëtor mirëmbajtje	Reparti Ushtarak nr. 3002, Rinas, në Forcën Ajrore	Rinas, Tiranë	E pacaktuar	Me dosje	-	01.10.2024	15.10.2024

Formulari nr. 1

1. Pozicioni i punës:	Punteor mirëmbajtje
2. Kodi i pozicionit:	3002C03010
3. Reparti/Institucioni:	Reparti Ushtarak nr. 3002, Forca Ajrore
4. Vendi:	Rinas, Tiranë
5. Paga:	Trajtohet me pagë sipas VKM nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar, Lidhja nr. II, II/I me Klasën VIII, (41.800) dhe shtesat mbi pagë për punë të vështirë e të dëmshme për shëndetin, sipas shkallëve të përcaktuara nga Inspektorati i Shëndetit Publik.
6. Lloji i kontratës së punës:	E pacaktuar
7. Data e fillimit të aplikimit:	01.10.2024
8. Data e mbylljes së aplikimit:	15.10.2024
9. Mënyra e aplikimit:	Me dosje
10. Dokumentat e aplikimit:	Aplikantët duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtëm; • Kërkesën personale; • Formularin e aplikimit; • Fotokopje të kartës së identitetit; • Dëftesën e shkollës së mesme të noterizuar me origjinalin; • Diplomë e arsimit të lartë/listë notash të noterizuar me origjinalin; • Fotokopje e patentës nëse ka; • Çertifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja; • Raport mjekësor; • Fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12, 2 copë; • Dëshmi penaliteti;

- Vërtetim gjykata;
- Vërtetim prokurorie;
- Librezë pune;
- Jetëshkrim (CV);
- Formulari i vetëdeklarimit;

11. Kërkesa të përgjithshme të vendit të punës:

- Të ketë shtetësi shqiptare;
- Të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të plotësojë kriteret për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin e përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- Të mos jetë i denuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- Të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

10. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- Grada/Titulli: Civil I;
- Arsimi: Nëntë vjeçar ose i mesëm i përgjithshëm;
- Kualifikimi: Të ketë kryer kurse dhe kualifikime të ndryshme profesionale;
- Trajnimi: Të jetë i trajnuar në kurse dhe kualifikime të ndryshme në fushën që mbulon;
- Eksperienca në Punë: Mbi 3 vjet;
- Gjuha e huaj: E paaplikueshme
- Kërkesa të tjera specifike: Të ketë eksperience të mëparshme në fushën që mbulon;
- Niveli i certifikatës së sigurisë; E paaplikueshme

11. Përshkrimi i punës:

Detyrat kryesore: Organizimi i punës për kryerjen në kohë dhe me cilësi të punimeve për higjienizimin dhe mirëmbajtjen e ambjenteve të punës dhe stërvitjes në repart.

- Të mirëmbaje sistemin kullues në territorin e repartit.
- Të raportojë rregullisht tek eprori për kontrollet e bëra dhe problemet e konstatuara.
- Të kontrollojë në mënyrë periodike dhe të punojë për zbatimin e masave të MNZSH.
- Të kryejë punime dhe riparime të ndryshme si dhe detyra shtesë në përshtatje me nevojat e shërbimit kur kërkohet nga eprori

Përgjegjësitë: Përgjigjet për kontrollin dhe higjienizimin e përhershëm të objekteve, ambjenteve të punës dhe stërvitjes, mirëmbajtjen, riparimin e tyre dhe plotësimin e dokumentacionit.

12. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.
Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Ajrore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët.

Komisioni verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse);

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.